



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1586 Prot.

Tiranë, më datë 15.11.2021

VENDIM
Nr. 638, datë 12.11.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknikë dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.11.2021:

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim aplikimin me objekt “*Punime prishje/ Objekt rrezik shembje*”, brenda kufirit të Qendrës Historike të qytetit të Shkodrës, me aplikues z. Bardhi Shllaku dhe zhvillues “Bijat Sigmatike të Shën Françeskut”, duke qenë se ndërhyrjet e kërkuara nuk janë pjesë e parashikimeve të Vendimit Nr. 771, datë 30.09.2020 “Për deklarimin pasuri kulturore të “Qendrës Historike” të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e Zonës Mbrojtëse të saj dhe miratimin e Planit për ruatjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”;
 2. Ngarkohet Sekretaria Teknikë për njoftimin e këtij Vendimi;
 3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

